

A background graphic consisting of a network of interconnected nodes and lines. The nodes are represented by circles of varying sizes, some in a light blue color and others in a slightly darker shade. The lines are thin and grey, creating a web-like structure across the entire page. In the bottom right corner, there is a large, semi-circular shape in a solid light blue color.

RRJETI I SHËRBIMEVE **SOCIO-SHËNDETËSORE**

● Bashkia Lezhë

RRJETI I
SHËRBIMEVE
SOCIO-SHËNDETËSORE

Bashkia **Lezhë**

Informacioni u mblodh nga
Organizata “Përfshirja Sociale për Zhvillim” (SIFD), Lezhë



Hartimi dhe publikimi i këtij dokumenti u realizua me mbështetjen e
Projektit “Shëndet për të Gjithë” të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe
Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC**



Tabela e Përmbajtjes

Hyrje	5
Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Lezhë	6
Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, Bashkia Lezhë	10
Qendra Komunitare Multifunksionale, Bashkia Lezhë	14
Qendra e Zhvillimit Ditor për Personat me Aftësi Ndryshe	16
Shtëpia “Rozalba” - Qendra e emergjencës për rastet e dhunës	18
Fondacioni “Mary Ward Loreto” (MWL)	22
Qendra Ditore për të Moshuarit - Kryqi i Kuq, Dega Lezhë	24
Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Lezhë	26
Shërbimi i Kujdesit Paliativ, Spitali Rajonal Lezhë	28
Shërbimi i trajtimit me metadon, Spitali Rajonal Lezhë	30
Shërbimi lëvizës për fëmijët me aftësi ndryshe, “Tungjatjeta...jetë”	32
Organizata Shqiptare e Urdhrit të Maltës, Malteser	34
Qendra ditore për shërbime sociale dhe passhkollore “Venerini”	36
Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore, Lezhë	38
Shtëpia Familje “Rozalba”	40
Shtëpia Familje “Carlo Acutis”	42

Hyrje

Rrjeti i Shërbimeve Socio-Shëndetësore në Bashkinë Lezhë është një nismë e mbështetur nga Projekti “Shëndet për të Gjithë” i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), në zbatim të “Strategjisë Kombëtare të Kujdesit Shëndetësor Parësor” 2020-2025. Dokumenti synon të fuqizojë shërbimin socio-shëndetësor në Kujdesin Shëndetësor Parësor (KSHP), përmes përmirësimit të qasjes dhe cilësisë së shërbimeve sociale, veçanërisht të atyre që synojnë arritjen e popullatave të cenueshme.

Ky dokument përbën një mjet pune që u vjen në ndihmë punonjësve socialë dhe ekipeve të mjekësisë së familjes pranë KSHP-së për të lidhur ose referuar pacientët drejt shërbimeve plotësuese, që nuk mund të ofrohen nga Qendrat Shëndetësore. Njëkohësisht, dokumenti u vjen në ndihmë aktorëve të tjerë lokalë të shërbimeve sociale dhe shëndetësore, si Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria e Shërbimit Social në Bashki, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror dhe Organizatat e Shoqërisë Civile në Bashkinë Lezhë, duke u mundësuar njohjen dhe koordinimin më të mirë të shërbimeve në zonën e tyre të mbulimit.

Rrjeti i Shërbimeve Shëndetësore dhe Sociale në Bashkinë Lezhë u përgatit gjatë periudhës kohore tetor 2024 – shkurt 2025, nga organizata “Përfshirja Sociale për Zhvillim” (SIFD), Lezhë.

Për realizimin e këtij dokumenti, falënderojmë Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, Drejtorinë e Shërbimit Social, në Bashki, Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Shërbimet e tjera publike dhe jopublike, si edhe Organizatat e Shoqërisë Civile në Bashkinë Lezhë, si bashkëpunëtorë të rëndësishëm në jetësimin e këtij procesi.

Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Lezhë

Lloji i institucionit Publik

Adresa Rruga “Frang Bardhi”, kati i 2-të, përballë Prefekturës, Lezhë
Tel.: 00355 21 52 22 18

Përfaqësues ligjor i institucionit **Zoje Zefaj**
Cel.: 00355 69 68 38 401 | Email: zoje.zefaj@gmail.com

Personi i kontaktit **Zoje Zefaj**
Cel.: 00355 69 68 38 401 | Email: zoje.zefaj@gmail.com

Mbulimi gjeografik Qarku Lezhë (*Bashkia Lezhë, Mirditë, Kurbin bashkë me NJA*)

Koha e ofrimit të shërbimit Prej vitit 1993

INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

 **Qëllimi i shërbimit** ➤ Të rrisë cilësinë e jetës për personat dhe grupet vulnerabël në qarkun Lezhë.

 **Fushat e shërbimeve** ➤ Shërbime shoqërore (përmes institucioneve të përkujdesjes sociale)
➤ Shërbime të pagesave për Ndhmë Ekonomike dhe Aftësinë e Kufizuar

 **Llojet e shërbimeve** Shërbime shoqërore (Institucione të përkujdesjes sociale)
➤ Monitorim të standardeve të shërbimeve sociale në rajon të ofruara nga Institucionet e Përkujdesjes Sociale, publike dhe jopublike, rezidenciale dhe ditore, që ofrojnë shërbime për fëmijët, të rinjtë, nënat e reja, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar.

Shërbime të pagesave të skemave për përkujdes shoqëror:

- Administrim të regjistrat elektronik për aplikantët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike, të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të përkujdesit shoqëror (përfshirë dosjet e të moshuarve për azil).
- Programim dhe detajim të fondeve për ndihmën ekonomike dhe aftësinë e kufizuar.
- Programim dhe shpërndarje të bonusit të foshnjës.

Shërbimet e monitoruara nga DRSHTSH Lezhë

Shërbime për personat me aftësi të kufizuar:

- Shërbime ditore për personat me aftësi të kufizuara
- Qendër terapeutike për personat me aftësi të kufizuara
- Shërbim lëvizës në familje për personat me aftësi të kufizuara

Shërbime sociale për të moshuarit:

- Shërbime ditore për të moshuarit

Shërbime sociale për gra të dhunuara/viktima trafikimi:

- Qendër emergjence 72 orëshe për gratë dhe vajzat viktima të dhunës

GRUPET PËRFITUESE

Kategoritë përfituese

- Personat me aftësi të kufizuara
- Të moshuarit
- Gratë dhe vajzat
- Fëmijët
- Familjet

Kriteret kualifikuese

Personat me aftësi të kufizuar:

- Persona para- dhe tetraplegjikë me aftësi të kufizuara të përcaktuara nga Komisioni Mjekësor për Caktim të Aftësisë për Punë.
- Rezidentë të qarkut Lezhë

Të moshuarit:

- Individë që kanë mbushur moshën për pension sipas legjislacionit në fuqi.
- Të moshuar të vetmuar, të braktisur, ose pa të ardhura që nuk zotërojnë tokë (*potencialë për t'u vendosur në rezidencë*).
- Të moshuar që përfitojnë pension social apo minimal.

Fëmijë dhe të rinj:

- Fëmijë dhe të rinj me status jetimi
- Fëmijë të vendosur në shërbim kujdestarie

Familjet/Individët:

- Familje me të ardhura të pamjaftueshme
- Gra të papuna me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç

Viktimat e trafikimit dhe dhunës në familje:

- Gra dhe vajza viktima të dhunës në familje (dhe fëmijët e tyre) të pajisur ose jo me UM ose UMM¹, që trajtohen ose jo në institucionet e përkujdesjes shoqërore.
- Gra dhe vajza viktima të trafikimit

¹ Urdhër mbrojtjeje (UM) dhe/ose UMM (Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje)

Identifikimi i përfituesve

Përmes:

- Koordinimit dhe zhvillimit të tryezave teknike për çështje të mbrojtjes sociale
- Shërbimeve publike të përkujdesjes dhe mbështetjes sociale në rajon
- Administratorëve shoqërorë të njësive administrative
- Kujdesit shëndetësor parësor dhe spitalor
- Verifikimeve në terren të punonjësve socialë
- Zyrës së Punës dhe Arsimit Profesional

INFORMACION ADMINISTRATIV

Numri i punonjësve

- 13 punonjës

Financuesi i shërbimit

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Burime të tjera të ardhurash

- Projekte dhe donatorë

Pagesa nga përfituesit

- Nuk ka

Koordinimi me shërbime të tjera

- Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, Bashkia Lezhë
- Njësitë Administrative për përfituesit e ndihmës ekonomike
- Zyra e punës, Lezhë
- Organizata të shoqërisë civile
- Institucione publike dhe jopublike që veprojnë në mbështetje të grupeve në nevojë.

O Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, Bashkia Lezhë

Lloji i institucionit	Publik
Adresa	Sheshi "Gjergj Kastrioti", Lagjja "Skënderbeg", 4501, Lezhë
Përfaqësues ligjor i institucionit	Pjerin Ndreu Email: kryetari@lezha.gov.al
Personi i kontaktit	Marte Fetaj Email: marta-lezhe@hotmail.com
Mbulimi gjeografik	Bashkia Lezhë dhe 9 Njësitë Administrative (<i>Shëngjin, Balldre, Blinisht, Kallmet, Dajç, Ungrej, Kolsh, Zejmen dhe Shënkoll</i>)
Koha e ofrimit të shërbimit	Prej vitit 2016

INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

- Qëllimi i shërbimit**
 - Të krijojë një sistem të integruar shërbimesh shoqërore që garantojnë mirëqënien dhe përfshirjen shoqërore të individëve, familjeve dhe komuniteteve.
- Fushat e shërbimeve**
 - Administrim, koordinim dhe monitorim të shërbimeve sociale në Bashkinë Lezhë.
 - Shërbime sociale, përfshirë shërbimin lëvizës.
 - Shërbime të strehimit social dhe ndihmës ekonomike.
- Llojet e shërbimeve**
 - Administrim, koordinim dhe monitorim të shërbimeve sociale:
 - Administrim dhe monitorim i Qendrave Ditore për shërbime sociale (*Qendra Ditore për PAK, Qendra Komunitare Multifunkionale, Bashkia, Qendra "Fuqizojmë Komunitetin" dhe Qendra Ditore për të Moshuarit*).
 - Koordinim i Shërbimit të urgjencës për rastet e dhunës në familje.
 - Drejtim i Grupeve Teknike Multidisiplinare (GTM) për menaxhimin e rasteve të fëmijëve, grave, të moshuarve, etj.
 - Koordinim i Ekipit Teknik Multidisiplinor (ETN) për rastet e dhunës në familje.
 - Koordinim i shërbimeve sociale në Bashkinë Lezhë për plotësimin e nevojave të grupeve vulnerabël.

Shërbime për kujdesin social:

- Shërbime për parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje.
- Shërbim për fëmijët dhe familjen, fuqizim ekonomik, programe prindërimi dhe fuqizim komuniteti.
- Shërbime sociale në mbështetje të arsimit, ri-integrim në shkollë dhe mbështetje familjare për nevojat arsimore të fëmijëve, klasa passhkollore.
- Shërbime rezidenciale 24 orëshe dhe afatgjata për fëmijët pa kujdestari prindërore dhe fëmijët në situatë rruge.
- Shërbim lëvizës në shtëpi për fëmijët me aftësi të kufizuara në zona të thella të Bashkisë Lezhë me synim integrimin e tyre në shoqëri.

Shërbime të strehimit social dhe ndihmës ekonomike:

- Programi i banesave sociale me qira /Subvencionim i qirasë
- Programi Social i Strehimit për “Subvencionimin e interesave të kredisë”
- Trajtimi me ndihmë ekonomike nga Fondi Shtesë i Fondit të Kushtëzuar (6%)

GRUPET PËRFITUESE

Kategoritë përfituese

- Fëmijët/të rinjtë
- Gratë dhe vajzat
- Të moshuarit
- Të rriturit
- Familjet

Kriteret kualifikuese

Fëmijët / të rinjtë:

- fëmijë dhe të rinj me statusin e jetimit
- jetimë që nuk janë në institucione
- fëmijë pa kujdes prindëror të vendosura në familje kujdestare
- të mitur (14-18 vjeç) dhe të rinj (18-21 vjeç), në konflikt me ligjin, në lirim pas kryerjes së dënimit, kur kanë nevojë për banesë dhe rehabilitim në shoqëri.

Gratë dhe vajzat:

- gra dhe vajza viktime të dhunës në familje (dhe fëmijët e tyre) të pajisura ose jo me UM ose UMM², që trajtohen ose jo në institucionet e përkujdesjes shoqërore.
- viktime të trafikimit, për periudhën që nga dalja nga institucionet e përkujdesjes shoqërore deri në çastin e punësimit.
- vajzat nëna, pas daljes nga programi i banesave sociale.

Të moshuarit

- të moshuar mbi 65 vjeç
- të moshuar të vetmuar
- të moshuar në kushte të vështira ekonomike dhe sociale
- të moshuar pa pasuri dhe prona

² Urdhër mbrojtjeje (UM) dhe/ose UMM (Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje)

Të rriturit:

- persona me aftësi të kufizuar
- invalidët e punës (sipas vlerësimit nga Komisioni Mjekësor për Caktim të Aftësisë për Punë të Invalidëve (KMCAAP)
- të papunët

Familjet:

- familje në vështirësi ekonomike dhe sociale
- familje në nevojë me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh
- familje nga pakicat etnike (romë, egjiptianë)
- familje me statusin e qiramarrësit në banesa ish-pronë private
- familjet e policëve të rënë në detyrë

Identifikimi i përfituesve

Përmes:

- Mekanizmit të koordinuar të referimit (përfshirë administratorët socialë).
- Referimit nga komisioni mjekësor i caktimit të aftësisë për punë.
- Referimit nga institucione të tjera lokale publike dhe private, OJF, individë.

INFORMACION ADMINISTRATIV

Numri i punonjësve

- 21 punonjës (*administrativë dhe teknikë: punonjës socialë, psikologë, fizioterapeutë, logopedë*)

Financuesi i shërbimit

- Bashkia Lezhë (buxheti i bashkisë)
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Fondi Social Shtetëror)

Burime të tjera të ardhurash

- Organizatat e shoqërisë civile

Pagesa nga përfituesit

- Nuk ka

Koordinimi me shërbime të tjera

- Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Qarku Lezhë
- Qendrat Shëndetësore në Bashkinë Lezhë
- Zyra e Punës dhe Formimit Profesional Lezhë
- Zyra Vendore Arsimore Lezhë
- Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë
- Organizata të Shoqërisë Civile

○ Qendra Komunitare Multifunkzionale, Bashkia Lezhë

Lloji i institucionit Publik

Adresa Rruga “Kosova”, Lagjja “Besëlidhja”, Lezhë

**Përfaqësues ligjor
i institucionit** **Pjerin Ndreu**
Email: kryetari@lezha.gov.al

**Personi i
kontaktit** **Ardita Zefi**

Mbulimi gjeografik Bashkia Lezhë dhe 9 Njësitë Administrative (*Shëngjin, Balldre, Blinisht, Kallmet, Dajç, Ungrej, Kolsh, Zejmen dhe Shënkoll*)

**Koha e ofrimit
të shërbimit** Prej vitit 2023

○ INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

○ **Qëllimi i shërbimit** ➤ Të nxisë përfshirjen sociale, fuqizimin dhe zhvillimin e komunitetit.

○ **Fushat e shërbimeve** ➤ Shërbime ditore për fëmijët
➤ Shërbime psiko-sociale për komunitetin

○ **Llojet e shërbimeve** Shërbime ditore për fëmijët:
➤ Shërbim ditor passhkollor për fëmijët e moshës 6-15 vjeç (*ndihmë me detyrat e shtëpisë, argëtim, socializim dhe aftësim për jetën*).
➤ Programe për zhvillimin e aftësive jetësore për fëmijët dhe të rinjtë.
➤ Aktivitete për promovimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit për çështjet e mbrojtjes së fëmijës dhe të drejtave.

Shërbime psiko-sociale për komunitetin:
➤ Këshillim psikologjik për individët dhe familjet në nevojë.
➤ Vizita në familje për identifikimin e nevojave social-ekonomike dhe referim i rasteve sipas nevojave.
➤ Program për forcimin e aftësive prindërore (klasat e prindërimit, grupet mbështetëse).
➤ Program i fuqizimit të të rinjve nëpërmjet trajnimeve dhe aktiviteteve për aftësimin për jetën.

GRUPET PËRFITUESE

Kategoritë përfituese	➤ Fëmijët ➤ Gratë ➤ Të rinjtë ➤ Personat në kushte të vështira sociale apo ekonomike
Kriteret kualifikuese	➤ Fëmijë (6-15 vjeç) dhe të rinj nga familje me probleme socio-ekonomike. ➤ Fëmijë në rrezik për abuzim, neglizhencë ose shfrytëzim. ➤ Gra viktime të dhunës në familje, të divorcuara, etj. ➤ Të rinj në nevojë për zhvillim të aftësive për jetën, nga familje në nevojë dhe subjekte të dhunës në familje. ➤ Individë në nivel të lartë cenueshmërie (social, ekonomik).
Identifikimi i përfituesve	Përmes: ➤ Njësisë së Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave, në Bashki ➤ Shërbimit social në Njësitë Administrative ➤ Qendrave Shëndetësore të Kujdesit Shëndetësor Parësor ➤ Drejtorisë së Shërbimit dhe Kujdesit Social në Bashkinë Lezhë ➤ Zyrës Vendore Arsimore dhe institucioneve në varësi ➤ Referimit nga organizata jofitimprurëse

INFORMACION ADMINISTRATIV

Numri i punonjësve	➤ 7 punonjës (1 menaxher, 1 psikolog, 1 punonjës social, 1 punonjës për NJVRN, 2 mësues, 1 sanitar)
Financuesi i shërbimit	➤ Bashkia Lezhë ➤ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Fondi Social Shtetëror)
Burime të tjera të ardhurash	➤ Organizata “Terre des hommes”
Pagesa nga përfituesit	➤ Nuk ka
Koordinimi me shërbime të tjera	➤ Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social Bashkia Lezhë ➤ Zyra e Punës ➤ Zyra Vendore Arsimore, Shkolla e Mesme Profesionale “Kolin Gjoka” ➤ Fondacioni “Mary Ward Loreto” ➤ Caritasi Dioqezan Lezhë

○ Qendra e Zhvillimit Ditor për Personat me Aftësi Ndryshe

Lloji i institucionit	Publik
Adresa	Lagjja “Gurra”, Lezhë
Përfaqësues ligjor i institucionit	Anduela Deda Cel.: 00355 69 25 11 324 Email: anduelaameri@hotmail.com
Personi i kontaktit	Matilda Çausi Cel.: 00355 69 81 09 142 Email: caushimatilda6@gmail.com
Mbulimi gjeografik	Qarku Lezhë (<i>Bashkitë Lezhë, Mirditë dhe Kurbin</i>)
Koha e ofrimit të shërbimit	Prej vitit 1996

○ INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

- **Qëllimi i shërbimit**
 - Të ofrojë rehabilitim të hershëm, gjithëpërfshirje dhe integrim për fëmijët me aftësi ndryshe.
- **Fushat e shërbimeve**
 - Shërbime ditore rehabilituese në qendër (*rehabilitim të funksioneve fizike, verbale, shqisore, etj.*)
 - Shërbime psiko-sociale
- **Llojet e shërbimeve**

Shërbime ditore rehabilituese në qendër:

 - Ofrim i terapive të zhvillimit psiko-motor.
 - Ofrim i seancave të fizioterapisë së personalizuar për personat me aftësi ndryshe.
 - Ofrim i terapisë ortofonike të personalizuar për personat me aftësi ndryshe.
 - Ofrim i seancave logopedike për zhvillim të të folurit për personat me aftësi ndryshe.

Shërbime Psiko-Sociale:

 - Mbështetje psiko-sociale për personat me aftësi ndryshe, përmes terapive individuale dhe në grup.
 - Mbështetje psiko-sociale për familjarët e personave me aftësi ndryshe përmes terapive individuale dhe në grup.
 - Socializim dhe integrim përmes aktiviteteve argëtuese, sociale dhe kulturore në mjediset e qendrës dhe jashtë saj.
 - Ofrim i një vakti ushqimor ditor për personat me aftësi ndryshe.
 - Ofrim i transportit për qasje në qendrën ditore për përfituesit e Njësisë Administrative Balldre.

GRUPET PËRFITUESE

- Kategoritë përfituese**
 - Komuniteti i qarkut Lezhë
- Kriteret kualifikuese**
 - Persona me aftësi të kufizuara mendore, të lehtë dhe të moderuar, të dokumentuar nga Komisioni Mjeko-Ligjor.
 - Persona me aftësi të të kufizuara motorike të lehta, të dokumentuara nga autoritetet mjekësore.
 - Mosha 6-25 vjeç
 - Personat me sindromën *Down* ose autizëm
 - Familjarët e personave me aftësi ndryshe
- Identifikimi i përfituesve**

Përmes:

 - Drejtorisë së Shërbimit dhe Kujdesit Social në Bashkinë Lezhë
 - Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Lezhë
 - Drejtorisë Arsimore Rajonale, Lezhë
 - Shërbimit Social Shtetëror, Tiranë

INFORMACION ADMINISTRATIV

- Numri i punonjësve**
 - 15 punonjës (*12 punonjës teknikë dhe 3 mbështetës*)
- Financuesi i shërbimit**
 - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
 - Bashkia Lezhë
- Burime të tjera të ardhurash**
 - Donatorë
 - Fabrika e çimentos "Colacem Albania" (*për transportin e përfituesve nga Njësia Administrative Balldre*)
- Pagesa nga përfituesit**
 - Nuk ka
- Koordinimi me shërbime të tjera**
 - Koordinim me partnerët e përmendur në pjesën "Identifikimi i përfituesve"
 - Bizneset lokale
 - Organizata të tjera joqeveritare, donatorë, komuniteti.

○ Shtëpia “Rozalba” - Qendra e emergjencës për rastet e dhunës

Lloji i institucionit	Publik/Fetar
Adresa	Gjadër, 4506, Lezhë
Përfaqësues ligjor i institucionit	Motër Alma Zogu Cel.: 00355 67 38 78 567 Email: almazogu84@gmail.com
Personi i kontaktit	Motër Alma Zogu Cel.: 00355 67 38 78 567 Email: almazogu84@gmail.com Sandër Vlashaj Cel.: 00355 69 23 48 099 Email: s_vlashaj@yahoo.it
Mbulimi gjeografik	Bashkia Lezhë dhe Njësitë Administrative (<i>Shëngjin, Balldre, Blinisht, Kallmet, Dajç, Ungrej, Kolsh, Zejmen dhe Shënkoll</i>)
Koha e ofrimit të shërbimit	Prej vitit 1999

○ INFORMACION TEKNIK MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

Qëllimi i shërbimit	➤ Të japë ndihmën e parë (deri në 72 orë) për viktimat e dhunës në familje.
Fushat e shërbimeve	➤ Shërbime emergjente të strehimit rezidencial ➤ Shërbime shëndetësore ➤ Shërbime psiko-sociale dhe të përkujdesjes ➤ Shërbime ligjore
Llojet e shërbimeve	Shërbime emergjente të strehimit rezidencial: ➤ Ofrim i strehimit të sigurt në rezidencë për 72 orë për gratë dhe vajzat viktimat të dhunës dhe fëmijët e tyre (nëse kanë). ➤ Sigurim i ushqimit, veshmbathjes, etj. në rezidencë. Shërbime shëndetësore: ➤ Shërbime shëndetësore të ofruara në qendër dhe jashtë saj (analiza, vizita mjekësore, medikamente, vizita okulistike dhe stomatologjike), sipas rastit për gratë dhe vajzat viktimat të dhunës.

Shërbime psiko-sociale dhe të përkujdesjes:

- Seanca këshillimi dhe mbështetje emocionale dhe psikologjike me psikologë dhe punonjës socialë për viktimat dhunës.
- Pjesëmarrje në aktivitete sociale dhe zhvilluese të fëmijëve të viktimave të dhunës.
- Regjistrim i fëmijëve të viktimave të dhunës në shkollë.
- Referim dhe ndërmjetësim për punësim.
- Integrim i viktimave në jetë të pavarur nga strehëza, në tregun e punës.

Shërbime ligjore:

- Ofrim i shërbimeve të avokatisë për ndjekjen e procedurave ligjore (*hartim dhe ngritje të kërkesë-padive, të kërkesave për divorc, mbrojtjes ligjore, procedurave të kujdestarisë, etj.*).
- Informim dhe këshillim ligjor i viktimave të dhunës.
- Përgatitje e dokumenteve për marrjen e Urdhrit të Mbrojtjes.
- Ndjekje dhe përfaqësim në procedurat gjyqësore dhe përfaqësim në seancat gjyqësore.

Shënim: Pothuajse në të gjithë rastet gratë dhe vajzat viktimat të dhunës qëndrojnë në qendrën e emergjencës deri në 3 muaj.

GRUPET PËR FITUESE

Kategoritë përfituese

- Gratë
- Vajzat
- Fëmijët
- Komuniteti

Kriteret kualifikuese

- Viktima të dhunës në familje, dhunës seksuale, etj.
- Viktima të trafikimit
- Viktima të dhunës mbi moshën 18 vjeç
- Fëmijë të grave viktimat të dhunës, çdo lloji dhune.
- Gra në kërkim të urdhrit të mbrojtjes.

Identifikimi i përfituesve

- Përmes:
- Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Lezhë
 - Shërbimit Social pranë Bashkisë Lezhë
 - Policisë Vendore, Lezhë

INFORMACION ADMINISTRATIV

Numri i punonjësve

- 12 punonjës (*psikologë, punonjës socialë, avokatë, edukatorë, administratë*)

Financuesi i shërbimit

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Bashkia Lezhë

- Burime të tjera të ardhurash**
 - Projekte dhe donatorë vendas dhe të huaj
 - Kongregata e Motrave Venerini
- Pagesa nga përfituesit**
 - Nuk ka
- Koordinimi me shërbime të tjera**
 - Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Lezhë
 - Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social në Bashkinë Lezhë
 - Sistemi Shëndetësor Parësor apo Spitalor
 - Policia e Shtetit/Gjykata/Prokuroria
 - Zyra Vendore Arsimore (shkollat)
 - Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje
 - Zyra e Punës
 - Organizatat e Shoqërisë Civile Lezhë

○ Fondacioni “Mary Ward Loreto” (MWL)

Lloji i institucionit	Fondacion
Adresa	Sheshi “Gjergj Kastrioti”, 4501, Lezhë
Përfaqësues ligjor i institucionit	Redion Qirjazi Cel.: 00355 68 41 17 108 Email: redion.qirjazi@marywardloreto.org
Personi i kontaktit	Afërdita Gjoni Cel.: 00355 67 60 99 144 Email: aferdita.gjoni@marywardloreto.org
Mbulimi gjeografik	Bashkia Lezhë dhe Njësitë Administrative (<i>Shëngjin, Balldre, Blinisht, Kallmet, Dajç, Ungrej, Kolsh, Zejmen dhe Shënkoll</i>)
Koha e ofrimit të shërbimit	Prej vitit 2015

○ INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

- **Qëllimi i shërbimit**
 - Të ndërtojë një komunitet të fuqizuar përmes parandalimit të trafikimit dhe dhunës me bazë gjinore.
- **Fushat e shërbimeve**
 - Shërbim strehimi emergjent (*ofrim i bonusit të qirasë për 3 muaj*).
 - Shërbim psiko-social për viktimat e dhunës me bazë gjinore.
- **Llojet e shërbimeve**
 - Shërbim strehimi emergjent për viktimat e dhunës me bazë gjinore:**
 - Sigurim i një ambienti të sigurt për viktimat e dhunës me bazë gjinore (të trafikuar ose jo) përmes ofrimit të bonusit të qirasë për 3 muaj.
 - Mbështetje për një jetesë të pavarur për viktimat e dhunës me bazë gjinore (të trafikuar ose jo).
 - Ofrim i paketave ushqimore dhe higjienike për jetesë të pavarur.
 - Shërbim psiko-social për viktimat e dhunës me bazë gjinore:**
 - Mbështetje psiko-sociale për viktimat e dhunës me bazë gjinore përmes seancave të këshillimit individual dhe në grup.
 - Mbështetje psiko-sociale për fëmijët e viktimave të dhunës me bazë gjinore.
 - Pagesë për pjesëmarrje në kurse profesionale (kuzhinë, estetikë, apo sipas prirjeve të përfitueses).
 - Orientim dhe ndërmjetësim për punësim; mbështetje me grante për hapjen e mikro-bizneseve.
 - Orientim dhe asistim për regjistrim në shkollë për viktimat dhe/ose fëmijët e tyre.
 - Pjesëmarrje në aktivitete social-integruese.

GRUPET PËRFITUESE

Kategoritë përfituese	➤ Gratë/vajzat ➤ Fëmijët
Kriteret kualifikuese	➤ Gra mbi moshën 18 vjeç ➤ Gra viktime të dhunës me bazë gjinore, dhunës seksuale, etj. ➤ Gra viktime të trafikut/viktima të mundshme të trafikut ➤ Gra përfituese të ndihmës ekonomike ose nga shtresa të marginalizuara ➤ Vajza të moshës 15-18 vjeç të braktisuara ose jetime ➤ Viktima të trafikimit ose viktime të mundshme të trafikimit
Identifikimi i përfituesve	Përmes: ➤ Mekanizmit të referimit dhe koordinimit të rasteve të trafikimit dhe të dhunës ➤ Koordinatorit për dhunën në Bashkinë Lezhë ➤ Policisë së Shtetit ➤ Përfaqësuesve fetarë në Bashkinë Lezhë ➤ Vetë komunitetit

INFORMACION ADMINISTRATIV

Numri i punonjësve	➤ 3 punonjës (1 menaxher, 2 punonjës socialë/psikologë)
Financuesi i shërbimit	➤ Fondacioni "Mary Ward Loreto", Dega Qendrore, Tiranë
Burime të tjera të ardhurash	➤ Donatorë nga Bashkimi European ➤ Donatorë të tjerë ➤ Bashkia Lezhë
Pagesa nga përfituesit	➤ Nuk ka
Koordinimi me shërbime të tjera	➤ Shërbimi Social në Bashkinë Lezhë ➤ Ekipi Teknik Ndërdisciplinar (ETN) në Bashkinë Lezhë ➤ Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Lezhë ➤ Policia Vendore ➤ Organizata të shoqërisë civile

○ Qendra Ditore për të Moshuarit - Kryqi i Kuq, Dega Lezhë

Lloji i institucionit Organizatë humanitare

Adresa Kati i 1 i Godinës së Ish Gjimnazit “Hydajet Lezha”, Lagjja Besëlidhja, Lezhë

Përfaqësues ligjor i institucionit **Jolanda Gjeçi**
Cel.: 00355 69 21 04 892 | Email: jolandagjeci76@gmail.com
dega.lezhe@kksh.org.al

Personi i kontaktit **Jolanda Gjeçi**
Cel.: 00355 69 21 04 892 | Email: jolandagjeci76@gmail.com
dega.lezhe@kksh.org.al

Mbulimi gjeografik Bashkia Lezhë dhe Njësitë Administrative (*Shëngjin, Balldre, Blinisht, Kallmet, Dajç, Ungrej, Kolsh, Zejmen dhe Shënkoll*)

Koha e ofrimit të shërbimit Prej vitit 1995

○ INFORMACION MBI LLOJIN E SHËRBIMEVE

○ **Qëllimi i shërbimit** ➤ Të përmirësojë cilësinë e jetës për të moshuarit, integrimin dhe shmangien e izolimit dhe përjashtimit social në Bashkinë Lezhë.

○ **Fushat e shërbimeve** ➤ Shërbime ditore psiko-sociale (*në qendër dhe banesë*)
➤ Shërbime shëndetësore (*ambulatorë në qendër dhe banesë*)
➤ Shërbime mbështetëse

○ **Llojet e shërbimeve** Shërbime ditore psiko-sociale (*në qendër dhe banesë*) për të moshuarit:
➤ Shërbime ditore për të moshuarit (socializim, integrim, argëtim) në mjediset e qendrës dhe jashtë saj.
➤ Mbështetje psikologjike për të moshuarit në banesë (nga vullnetarët e Kryqit të Kuq) dhe në qendër.
➤ Biseda, këshillime dhe diskutime individuale apo në grup me të moshuarit për menaxhimin e stresit, vetmisë, përmirësimin e mirëqënies psikologjike dhe shëndetit mendor të të moshuarve.
➤ Mbështetje psikologjike për familjarët/bashkëshortët e moshuar sidomos në raste të katastrofave apo fatkeqësive natyrore apo rasteve të emergjencave.
➤ Mbështetje me pako ushqimore për të moshuarit.

Shërbime shëndetësore ambulatorë:

- Ndhmë në monitorimin e sëmundjeve kronike, matje të tensionit arterial, monitorim të parametrave vitale, administrim i medikamenteve, etj.
- Edukim shëndetësor rreth aktivitetit fizik, ushqyerjes së shëndetshme, menaxhimit të sëmundjeve kronike, parandalimit të rrëzimeve në kushtet e shtëpisë, etj.

Shërbime mbështetëse:

- Ndhmë për hartim dokumentacioni dhe përfitimet sociale.
- Këshillim për të drejtat e pensionistëve dhe shërbime ligjore bazë.

GRUPET PËRFITUESE

Kategoritë përfituese	➤ Të moshuar që kanë mbushur moshën e daljes në pension
Kriteret kualifikuese	➤ Të moshuar me nevoja social-ekonomike ➤ Të moshuar me ndihmë ekonomike ➤ Të moshuar të vetmuar ➤ Të moshuar me probleme shëndetësore
Identifikimi i përfituesve	Përmes: ➤ Shërbimit Social në Bashki ➤ Administratorëve socialë në Njësitë Administrative në Bashkinë Lezhë ➤ Shërbimeve shëndetësore parësore ➤ Organizatave të tjera publike që ofrojnë shërbime sociale ➤ Organizatave të shoqërisë civile ➤ Rrjetit të vullnetarëve në Bashkinë Lezhë dhe vizitave në banesë ➤ Qytetarëve që paraqiten vullnetarisht pranë zyrave të Kryqit të Kuq

INFORMACION ADMINISTRATIV

Numri i punonjësve	➤ 4 punonjës (2 mjekë dhe 2 staf administrativ)
Financuesi i shërbimit	➤ Kryqi i Kuq Shqiptar
Burime të tjera të ardhurash	➤ Bashkia Lezhë
Pagesa nga përfituesit	➤ Nuk ka
Koordinimi me shërbime të tjera	➤ Koordinimi me shërbimet e përmendura si partnerë tek "Identifikimi i përfituesve".

O Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Lezhë

Lloji i institucionit	Organizatë humanitare
